



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. 324/7 Prot.

Pogradec, më 22.01.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK

E nderuar znj. Kryetare, Manjola KAMOLLI

Bashkegjitur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim Projekt Vendimin per:
**PËR NJE SHTESE NË VENDIMIN NR 128 DT 22.12.2025, PËR MIRATIMIN DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2026"**

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.2026

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË _____.2026

PER

**PËR NJE SHTESE NË VENDIMIN NR 128 DT 22.12.2025, PËR MIRATIMIN DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2026"**

Në mbështetje të, shkronjës "c", pika 1.3, të nenit 9, neneve 34, 40, 41, shkronjës "dh" të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrise se Financave nr.2, date 06.02.2012, "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar me nr 6 dt 16.05.2024 , Vendimin nr.128 datë 22.12.2025 "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2026", shkresën nr. 18133/1, datë 24.12.2025, në zbatim të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Granti i Performancës për bashkitë", si dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 1031/5, datë 11.07.2025 dhe nr. 10725, datë 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e Grantit të Bazuar në Performancë për Bashkitë për vitin 2025, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Te miratoje shtesen ne Buxhetin e Bashkise Pogradec si me poshte:

Grupi	Kapitulli	Titulli	Artikulli	Kodi Insitucionit	Vlera me TVSH
00	01	04960	604	2136001	4,404,494.38
00	01	04960	604	2136001	5,444,356.62
					9,848,851.00

2. Te miratoje shperndarjen si me poshte

Grupi	Kapitulli	Titulli	Artikulli	Kodi Insitucionit	Vlera me TVSH
00	01	01110	231	2136001	4,404,494.38
00	01	01110	231	2136001	5,444,356.62

3.Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkise, Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkise Pogradec.

4. Vendimi të hyjë në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETAR

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 329/7 Prot.

Pogradec, më 22.01.2026

RELACION

**PËR NJE SHTESE NË VENDIMIN NR 128 DT 22.12.2025, PËR MIRATIMIN DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2026"**

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt - Vendimi që po ju paraqesim vjen si rrjedhojë e shkresën nr. 18133/1, datë 24.12.2025, në zbatim të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Granti i Performancës për bashkitë", si dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 1031/5, datë 11.07.2025 dhe nr. 10725, datë 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e Grantit të Bazuar në Performancë për Bashkitë për vitin 2025".

Ky grant ju akordohet Bashkive në bazë të plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga Ministria. Çdo document ka patur një perëindje të caktuar të vlerësimit të cilat më pas do të mbidhen dhe do të llogaritet fondi për çdo Bashki. Përqindjen më të lartë të e kishte Plani i hartimit dhe mbarështimit të pyjeve dhe dokumntat e tjerë që kërkoreshin ishin Plani i barazisë Gjimore, Plani i

Arsimit Parauniversitar, treguesit e matjes së Sistemit të performancës, niveli i pagesës së borxheve etj. Në bazë të përqindjeve Bashkia Pogradec ka përfituar 9,848,851 lekë.

Për shkak të kushteve të pafavorshme atmosferike të ditëve të fundit, si reshjet e dendura të shiut, përmytjet lokale dhe vështirësitë në qarkullim, është evidentuar nevoja e shtuar për ndërhyrje të shpejtë dhe të vazhdueshme nga ana e shërbimeve tona. Mjetet aktuale në dispozicion janë të pamjaftueshme dhe në disa raste të papërshtatshme për përballimin e situatave të krijuara, duke sjellë vonesa në kryerjen e detyrave dhe kufizim të shërbimit ndaj qytetarëve. Përballë këtyre kushteve, sigurimi i 2 (dy) mjeteve motorike shtesë është i domosdoshëm për garantimin e ndërhyrjeve në kohë, lëvizshmërisë dhe vijueshmërisë së shërbimeve. Blerja e këtyre mjeteve do të ndikojë drejtpërdrejt në:

- Përballimin më efikas të situatave të shkaktuara nga kushtet atmosferike
- Rritjen e gatishmërisë dhe shpejtësisë së reagimit

- Sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike

Në mbështetje të sa më sipër, kërkojmë miratimin e Bashkisë për procedimin e blerjes së 2 mjeteve motorike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Ju Faleminderit,

KRYETAR

ILIR XHAKOLLI